**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË 31.03.2022

Me datë 31.03.2022, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër.Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija,Bledianë Nika, Ermina Gruda, Ardiana Ndreu, Diana Muriqi, Jona Leqejza, Tereze Brigja,Vjollca Petani, Sabahete Lishi,Dhurata Tyli,Sabina Danaj,Donika Ndoja,Diandra Kraja, Arvit Osja, Erion Metushi, Elson Celiku,Hilmi Lakti, Sokol Zaimaj,Lulash Nika, Hekuran Gjorretaj, Anton Deda, Blerim Dimnaku, Gjergj Sokoli,Andi Halluni,Lindita_Nika, Nadir Spahija.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

**A.**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Shkurt 2022".*
2. Pr/ Vendim *"Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2021 të Bashkisë Shkodër"*
3. Pr/ Vendim *"Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër"*
4. Pr/ Vendim *"Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2023-2025"*
5. Pr/ Vendim *"Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025"*

**B.**

Mbështetur në pikën 3 të nenit 60 të ligjit nr.139/2015 "Për qeverisjen vendore",bëhet shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,për zgjedhjet e pjesshme për organet e

qeverisjes vendore të datës 06.03.2022,sipas vendimit të Gjykatës Shkodër nr.53,datë 20.03.2022,dhe betimi i Kryetarit.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, prandaj vijohet me hedhjen në votim të rendit të ditës.
Z.Vukaj propozon që betimi i Kryetarit të ri të bëhet fillimisht, meqënëse pikat e rendit të ditës janë shumë të rëndësishme me punën që do ketë këtë mandat.Kryetarja e Këshillit sqaron rregulloren dhe thekson që ky fakt nuk përbën asnjë ndryshim prandaj vijohet me votimin e rendit të ditës, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
***Miratohet***

**1.**Mbledhja vijon me Pr/Vendimin *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Shkurt 2022"*

Kryetarja e Bashkisë merr fjalën dhe relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.Kryetarët e grupeve shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
***Miratohet***

**2.**Vijohet me Pr/ Vendim *"Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2021 të Bashkisë Shkodër"*

Përsëri relaton Znj.Ademi,e cila sqaron më hollësisht edhe njëherë materialin e përgatitur nga administrata,ku përmend edhe realizimet që Bashkia e Shkodrës ka bërë.

Znj.Leqejza në emër të Komisionit të buxhetit dhe kontrollit financiar shprehet dakort por njëkohësisht ajo sqaron se ky Pr/Vendim është thjesht formal meqënëse buxheti tashmë është zbatuar.Vlen të theksohet fakti që vazhdon të verehet një mosrealizim i disa shpenzimeve,kjo ndoshta si pasojë e një performance të munguar e Bashkisë Shkodër.Komisioni shpreson në një përmirësim në vazhdimësi.

Në emër të Grupit të këshillëtarëve Socialistë ,Z.Osja shprehet pro këtij Pr/Vendimi. Gjithashtu edhe Z.Sokoli shpreh dakordësi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 25vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.
***Miratohet***

**3.**Vijohet me pikën 3 të rendit të ditës. Pr/ Vendim *"Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër"*

Përsëri fjala për Znj.Ademi e cila ralaton sipas materialit të përgatitur dhe sqaron në lidhje me projektin (FARO),projekt ky i financuar plotësisht nga Bashkimi Europian dhe cdo aktivitet në kuadër të tij.Projekti FARO është i shtrirë në shume vende,të cilat janë pjesë e këtij projekti

prandaj Shkodra si qytet, që ka për të treguar shumë ne lidhjë me temën e këtij projekti i është bashkuar dhe si rrjedhojë vijmë me këtë shtesë fondi në buxhet .

Kryetarët e grupeve shprehen pro miratimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
***Miratohet***

Kryetarja e Këshillit sqaron se për pikën 4 dhe 5 të rendit të ditës do relatojë kryetarja e Bashkisë ,por diskutimet dhe votimi do kryhet ndaras për secilën pikë.

**4.**Vijohet me pikën 4 të rendit të ditës. Pr/ Vendim *"Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2023-2025"*

**5.**Vijohet edhe me pikën 5 të rendit të ditës. Pr/ Vendim *"Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025"*

Z.Ademi merr fjalën përsëri dhe relaton sipas materialit të përgatitur nga administrata, në lidhje me tavanet buxhetore dhe përsërit nevojën e herë pas herëshme të diskutimeve në lidhje me këtë.

Në total si Bashki parashikohet që niveli i të ardhurave të vijë në rritje,kryesisht për disa të ardhura ose për disa zëra që kanë nevojë për rishikim.Të detajuara gjendet në tabelat dhe relacionet bashkangjitur këtij Pr/Vendimi.Cdo gjë e kryer konform ligjit për financat e qeverisjes vendore.

Z.Leqejza shprehet kundra këtyre Pr/Vendimeve sepse mendon që ka mangësi dhe e sheh me skepticizëm realizimin e parashikuar të tyre.

Po ashtu edhe Kryetarët e grupeve shprehen kundër këtij Pr/Vendimi. Projekt akti nr.4 hidhet në votim, ku rezultojnë 0 vota Pro, 26 Kundër, 0 Abstenim.
***Nuk miratohet***

Merret mendimi i kryetarëve të grupeve edhe në lidhje me pikën 5 të rendit të ditës.
Kryetarët e grupeve ,Z.Osja dhe Z.Sokoli shprehen përsëri kundër.
Projekt akti nr.5 hidhet në votim, ku rezultojnë 0 vota Pro, 26 Kundër, 0 Abstenim.
***Nuk miratohet***

Vijohet me fjalën e rastit të Kryetares së Bashkisë Znj.Ademi në përmbyllje të detyrës së saj.
Më pas pasohet me betimin e Kryetarit të ri të Bashkisë së Shkodrës dhe fjalën e tij të rastit.

Kryetarja e Këshillit Znj.Truma deklaron të mbyllur mbledhjen.

*Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 31.03.2022. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).*

*Procesverbali përmban 4 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:*

***Sekretar***

***Denis LESHA***

***KRYETARE***

***Brisela KADIJA***

BASHKIA SHKODËR-REPUBLIKA E SHQIPËRISË